

VENDIM
Nr. 26, datë 13.10.2022

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, kreu II, neni 4, pikat “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, ‘Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 26, datë 13.10.2022, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje agjenturale nr. 4640 “Maska e Vjetër”, me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë, ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 18 (tetëmbëdhjetë) dokumente me 30 (tridhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

2. Dosje formulare nr. 4096, në ngarkim të M. Xh., me 20 (njëzet) fletë ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Emigrantët Ekonomik.

3. Dosje formulare nr. 2189, në ngarkim të N. Sh., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë, ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Korçë.

4. Dosje përpunimi nr. 2370, në ngarkim të Th. B., me 106 (njëqind e gjashtë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 49 (dyzet e nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitet 1972-1991. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë.

5. Dosje fashikullore nr. 2751, në ngarkim të N. Gj., me 5 (pesë) fletë ndër të cilat 2 (dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Emigrantët Ekonomik.

6. Dosje personale nr. 2328, në ngarkim të I. F., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë, ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

7. Dosje përpunimi nr. 1631, në ngarkim të S. Ç., me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë, ndër të cilat 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Sarandë.

KRYETAR I KDZH
Gentiana Sula